



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 271, datë 28.12.2020

MBI

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË
RINOVUESHME NGA DIELLI, ERA DHE NGA PJESA E BIODEGRADUESHME E
MBETJEVE TË NGURTA QË SHFRYTËZOJNË MBETURINAT INDUSTRIALE,
URBANE DHE RURALE PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 17.1.2018 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/14 Prot, datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

Konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.
- VKM nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj Metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM përsa i takon LCOE

dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- VKM nr. 27, datë 17.1.2018 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” përcakton ndër të tjera se për investimet për të cilat subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës pas datës 1 janar 2018 e në vijim, ERE do të miratojë çmimin në bazë të të dhënave të grumbulluara, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e kësaj metodologjie.
- Në themel të metodologjisë së miratuar me VKM nr. 369, date 26.04.2017 është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-se (kosto e niveluar e energjisë elektrike) si me poshtë vijon:

$$LCOE = \frac{\sum \text{e kostove gjatë jetëgjatësisë}}{\sum \text{e energjisë elektrike të prodhuar gjatë jetëgjatësisë}} = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{I_t + M_t + F_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

Ku: I_t - Shpenzimet për investime në vitin t

M_t - Operacionet dhe Shpenzimet e Mirëmbajtjes në vitin t

F_t - Shpenzimet e lëndës djegëse në vitin t (taksa vjetore, përdorimi i tokës, qira etj.)

E_t - Energjia elektrike e gjeneruar në vitin t

r - Norma e interesit të kostos së impiantit

n - Jetëgjatësia ekonomike e njësisë gjeneruese

- Ndërkohë, metodologjia e miratuar me VKM nr. 27, datë 17.1.2018 përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit që duhet të paguhet për një njësi *output* si pagesë për fuqinë e prodhuar, me qëllim që të arrihet një rikthim financiar i caktuar – ose të vendoset thjesht çmimi që projekti duhet të fitojë për mwh, me qëllim që të arrihet *break-even* ose të ardhurat të barazojnë kostot e prodhimit.

$$LCOE = \frac{\sum_{t=0}^n \frac{C_{I,t} + C_{l,djeg,t} + C_{O\&M,t}}{(1+r)^t}}{\sum_{t=0}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

- ERE në mbështetje të përcaktimeve të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe akteve nënligjore në fuqi, nisur nga eksperiencia e deritanishme për miratimin e çmimeve të prodhuesve me përparësi mbështetur në legjislacionin sipërcituar, me ane të shkresë nr. __, date __.12.2020 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka kërkuar informacion lidhur me subjektet për të cilat kjo e fundit ka lëshuar (1) autorizimin paraprak, (2) miratimin përfundimtar për ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli dhe era; si dhe gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

- Informacioni i kërkuar me anë të shkresës sipërcituar, do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.
2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI